

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

Procedurë e hapur e thjeshtuar

Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i Përkthimit, i Dokumentave Standarde të Procedurave të Prokurimit Mbi Kufirin e Lartë Monetar në Bashkinë Tiranë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
79530000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,944,000 (Katër milion e nëntëqind e dyzet e katër mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur sipas nenit 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është parashikuar se:

Pika 1, Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2, Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022,2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë me vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet .Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007

“Per QKR” i ndryshuar. Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi do të konkludojë me një kontratë shërbimi për të dëshmuar përvojën e mëparshme vlera totale e kërkuar Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- të paktën 1 (një) përkthyes i çertifikuar në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” (*çertifikata përkatëse*). (në rastin kur operatori ekonomik është një kompani përkthimi);
- kur përkthyesi është person fizik, i vetëpunësuar i jetë i licencuar nga Ministria e Drejtësisë.

Për plotësimin e kriterit të mësipërm është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 9. Operatori ekonomik që do të shpallet i kualifikuar në vënd të parë, para formularit të fituesit (paraprak), duhet të dorëzojë dokumentacionin, si më poshtë:

- a. Kontratë pune të vlefshme;
- b. Diplomë të shkollës së lartë për gjuhën angleze;
- c. Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit . Listë pagesa duhet të përmbajë kodin e punonjësit, i cili është respektivisht kodi i përkthyesit sipas listës kombëtare të profesioneve, të parashikuar në VKM-në nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar”.

Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit do të plotësohen si nga përkthyesi që aplikon si person fizik, ashtu edhe nga kompania e përkthimit, apo bashkimi i operatorëve ekonomikë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Nisur nga natyra e shërbimit që do të realizohet për përkthimin e dokumentave standarte të tenderit dhe çdo dokument bashkëlidhur me to, është gjuar e arsyeshme që operatori ekonomik të ketë të punësuar minimalisht të paktën të paktën 1 (një) përkthyes i çertifikuar në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”(çertifikata përkatëse),(në rastin kur operatori ekonomik është një kompani përkthimi) ose kur përkthyesi është person fizik, i vetëpunësuar të jetë i licencuar nga Ministria e Drejtësisë i cili do të kryejnë shërbimin e përkthimit sa herë që del e nevojshme për të përmbushur nevojën e institucionit.

2.3.3 Vendbanimi i përkthyesit zyrtar ose vendi i ushtrimit të veprimtarisë së përkthimit zyrtar të jetë në apo pranë juridiksionit të Autoritetit kontraktues;

Argumentimi: Në bazë të VKM-së **Nr. 407, datë 5.7.2023 PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË RREGULLAVE PËR PËRZGJEDHJEN, KONTRAKTIMIN DHE SHPËRBLIMIN E PËRKTHYESVE ZYRTARË, SI DHE TË MËNYRËS SË KONTROLLIT TË SHËRBIMIT TË KRYER NGA PËRKTHYESIT ZYRTARË, Neni 4 pika b)** Vendbanimi i përkthyesit zyrtar ose vendi i ushtrimit të veprimtarisë së përkthimit zyrtar të jetë në apo pranë juridiksionit të organit kontraktues;

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a) ISO 9001 për sistemin menaxhimin e cilësisë;

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar).

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për cilësinë dhe realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Shërbimi i Përkthimit, i Dokumentave Standarde Të Proçedurave Të Prokurimit Mbi Kufirin e Lartë Monetar në Bashkinë Tiranë”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

*Dokumentat e tenderit
Termet e referencës*

NJËSIA E PROKURIMIT